

27.03.2010; "EPOKA E RE"

Është mbajtur takimi nismëtar për projektin "Mbështetja dhe Zhvillimi i Strukturave për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë"

# Projekt për ngritjen e cilësisë së studimeve në institucionet private

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurimin e cilësisë në 10 institucione private të Arsimit të Lartë të Kosovës. Ndërsa, qëllimi afatgjatë është: përmirësimi i cilësisë së këtyre institucioneve në bazë të Strategjisë mbi Arsimin e Lartë për periudhën 2005-2015, parimeve të Procesit të Bolonjës si dhe dokumenteve të tjera relevante

EPOKA  
ERE

Lirije KLAIQI

PRISHTINË, 26 MARS - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe WUS Austria, në bashkëpunim me partnerët e tjerë vendorë dhe evropianë, kanë mbajtur të premtën takimin nismëtar për projektin "Mbështetja dhe Zhvillimi i Strukturave për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë", të mbështetur nëpërmjet Programit TEMPUS, e të financuar nga Komisioni Evropian.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurimin e cilësisë në 10 institucione Private të Arsimit të Lartë të Kosovës. Ndërsa, qëllimi afatgjatë është: përmirësimi i cilësisë së këtyre institucioneve në bazë të Strategjisë mbi Arsimin e Lartë për periudhën 2005-2015, parimeve të Procesit të Bolonjës si dhe dokumenteve të tjera relevante.

Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, me këtë rast ka thënë se Republika e Kosovës gjatë vitit 2008-09 ka bërë përpjekje maksimale që ta definojë se dija dhe kërkimi shkencor janë shtylla për zhvillim ekonomik, për modernizim social dhe për zhvillim kulturor.

"Jam shumë i nderuar që një prioritet që e kemi filluar në vitin 2008-09, i cili ka qenë i përmbledhur me tri fjalë, cilësi, cilësi, dhe

vetëm cilësi, është duke ecur përpara. Në kuadër të procesit të akreditimit kemi arritur ta rregullojmë tregun e dijës në fushën e arsimit të lartë dhe sot të dallojmë shumë prej vendeve të tjera të rajonit", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka thënë se për MASHT-in, sektori publik dhe sektori privat në Kosovë janë të barabartë për nga roli, funksioni dhe qëllimet.

"Por, përderisa sektori publik ekziston për shkak të domosdoshmërisë publike, sektori privat duhet të ekzistojë për shkak të cilësisë dhe të fleksibilitetit që ka ekonomia jonë e tregut", ka thënë Hoxhaj.

Në vazhdim, menaxheri i WUS-Austria për Kosovën, But Dedaj, ka thënë se ky projekt do të ndihmojë në zhvillimin e cilësisë së arsimit në institucionet private.

"Ky është një projekt nismëtar për zbatimin e projektit Tempus, që ka të bëjë me zhvillimin dhe formimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë", ka thënë Dedaj.

Për rëndësinë e këtij projekti ka folur edhe përfaqësuesja e Komisionit Evropian në Kosovë, Sophie Beamont.

Ajo ka thënë se ky projekt do t'u ndihmojë drejtpërdrejt studentëve, por edhe ekonomisë së Kosovës.

"E rëndësishmja e këtij projekti është që ofertat që ofrohen nga

programet e Tempus-it, të kenë rezultate në plotësimin e kërkesave të studentëve, e që, ndër të tjera, është sigurimi i cilësisë", ka thënë ajo.

Ndërkaq, përfaqësuesi i Universitetit të Salsburgut, Peter Eckl, ka theksuar se programet e Tempus-it duhet të gjejnë realizim edhe në Kosovë, mirëpo edhe nëse kjo do të jetë në një tempo të ngadalshëm, institucionet e larta profesionale arsimore, fillimisht duhet t'i informojnë ata rreth këtyre programeve, në mënyrë që qasja e studentëve drejt këtyre programeve të jetë më e lehtë.

Përfaqësuesit e Institucioneve Private të Arsimit të Lartë e kanë vlerësuar mundësinë që po iu jepet me këtë projekt, në mënyrë që të ngritin edhe më tej cilësinë e studimeve dhe të jenë në shërbim sa më të mirë të studentëve.

Përfitues të këtij projekti janë 10 institucione private të Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës.

Projekti do të implementohet me ekspertizën e ofruar nga tri universitete të njohura evropiane në lëmin e sigurimit të cilësisë: Universiteti i Salzburgut, University College Cork, Irland dhe Universiteti POLITEHNICA në Bukuresht, WUS Austria's, dhe në mbështetje strategjike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare për Akreditim.

